



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1365/6 prot.,

Datë 20.05.2026

V E N D I M
Nr.674/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur, Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24(njëzet e katër) mujor”, me REF-78968-03-11-2026, me objekt: “Blerje vegla pune”, me fond limit 11,288,300 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 15.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë

Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik Ervin Luzi nga procedura e mësipërme.

Ankimues: Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me Nipt M113130290 dhe adresë: Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi rezidencial “Magnet” Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, Tiranë.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik Ervin Luzi me Nipt K71707007Q dhe adresë: Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik
Rruga “5 Maji” , Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi “Bajro Bros” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.03.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur, Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24(njëzet e katër) mujor”, me REF-78968-03-11-2026, me objekt: “Blerje vegla pune”, me fond limit 11,288,300 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 15.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

II.2. Në datën 15.04.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 23.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Bajro Bros” SHPK	8,466,225	lekë s’kualifikuar
2. “ INPLY” SHPK	10,500,000	lekë kualifikuar
3. Ervin Luzi	8,466,225	lekë s’kualifikuar

II.4. Në datën 23.06 operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“• *Operatori Ekonomik “Bajro Bros” sh.p.k nuk ploteson piken 2 Kapaciteti teknik: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST.....Pasi KVO konstaton nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të kompanisë përkatëse rezulton se “Sarac Teknik Hirdavat” dhe analizimi i dokumentacionit ngarkuar ne SPE për autorizimin e paraqitur, nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, por një distributor i disa markave. Në këto kushte, autorizimi i paraqitur nga ana juaj, i lëshuar nga një subjekt që nuk ka statusin e prodhuesit, nuk përmbush kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe konsiderohet i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë me prodhuesin apo përfaqësimin e autorizuar prej tij.*

• *Operatori Ekonomik “Bajro Bros” sh.p.k nuk ploteson piken 4 Kapaciteti teknik: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose/dhe skeda teknike të mallrave objekt prokurimi, të cilat kërkohen në tabelën e mësipërme, të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST.pasi lidhur me katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” në përmbushje të kriterit KVO nga analizimi*

i dokumentacionit ngarkuar ne SPE ,konstaton se zerat e katalogut të paraqitur nga ana e OE, janë konstatuar mospërputhje të dukshme ndërmjet specifikimeve teknike të kërkuara dhe produkteve të paraqitura per zerat GJENERATOR ELEKTRIK 7 kW – SERIA GV dhe MOTORGJENERATOR MONOFAZË 3.3 kVA. Nga kerkimi ne web per GJENERATOR ELEKTRIK 7 kW dhe MOTORGJENERATOR MONOFAZË 3.3 kVA del me logon e LYNX dhe ne asnje nga dokumentacionet e autorizimeve per distributor apo prodhues nuk behet lidhja ndermjet tyre dhe markes LYNX. Këto mospërputhje tregojnë qartë se katalogu i paraqitur nuk përfaqëson dokumentacionin teknik të saktë dhe të verifikueshëm të një prodhuesi apo distributori të autorizuar nga prodhuesi pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga distributoret TOOLS MARKET dhe MUCA shpk verehet se produktet e paraqitura nga OE Bajro Bros ne katalogun e tij kane mosperputhje me specifikimet teknike dhe fotot ilustruese dhe per disa zera nuk rezultojne fare ne faqet e web perkates te dy distributoreve. Sa me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit te ofertes per gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatori Ekonomik “Bajro Bros” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e skualifikuar kete operator ekonomik..”

II.5. Në datën 28.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 04.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6612 datë 04.05.2026 dhe me nr.1365 prot., datë 04.05.2026e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

“...-A - Ne lidhje me kundërshtimin e skualifikimit te ofertes se BAJRO BROS, keto jane argumentat qe kundërshtojne dhe rezojne pretendimet e KVO -se AK per skualifikimin e ofertes tone: Si paranteze:

Deshirojme ti kujtojme KVO-se, se me refuzimin e padrejte te ofertes tone, demi ekonomik qe i shkaktohet AK dhe shtetit eshte AFRO 2000000 leke te reja !!

Si dhe, i deklarojme KVO-se se, duke qene se ne kemi paraqitur autorizime nga 2 distributore, KVO-JA, te mos e konsideroje autorizimin nga distributori 2 (MUCA), sepse eshte dokument i tepert, dhe te mjaftohet me vleresimin e autorizimit nga distributori TOOLS MARKET, me emertimin - 10-Autorizime nga distributoret 1.

1- Persa i perket arsyes se pare te skualifikimit, (1- OE Bajro Bros shpk nuk ploteson piken 2 Kapaciteti Teknik: iOperatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për

Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST??..”, pasi KVO ja konstaton nga verifikimi I kryer ne faqen zyrtare te kompanise perkatese rezulton se “Sarac Teknik Hirdavat”, dhe analizimi I dokumentacionit te ngarkuar ne SPE per autorizimin e paraqitur, nuk eshte prodhuesi i mallrave objekt prokurimi, por nje distributor i disa markave. Ne keto kushte, autorizimi i paraqitur nga ana juaj, i leshuar nga nje subjekt qe nuk ka statusin e prodhuesit, konsiderohet i pasakte dhe i pamjaftueshem per te provuar lidhjen e drejtperdrejte me prodhuesin apo perfaqesimin e autorizuar prej tij), theksojme se:

Ne permbushje te pikes 2 te kapacitetit Teknik te kerkesave per kualifikim te DT: 12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST...”

Ne kemi paraqitur dokumentin 10-Autorizime nga distributoret 1, si dhe dokumentin 12-Autorizim nga distributori 2.

Sic e deklaruar edhe me lart, - duke qene se ne kemi paraqitur autorizime nga 2 distributore, KVO-JA, te mos e konsideroje autorizimin nga distributori 2 (MUCA), sepse eshte dokument i tepert, dhe te mjaftohet me vleresimin e autorizimit nga distributori TOOLS MARKET, me emertimin - 10-Autorizime nga distributoret 1. (te cilin mesa duket, KVO-ja nuk e ka pare !!) Keshtu qe KVO-ja, duhet te vleresonte dhe te merte ne konsiderate autorizimin kryesor nga TOOLS MARKET, distributor zyrtar i disa prodhuesve.

Autorizimi i paraqitur nga ana jone i distributorit TOOLS MARKET, eshte teresisht ne perputhje me kerkesen e DT, duke qene edhe i shoqeruar me TE GJITHA LIDHJET e distributorit me prodhuesit perkates (te gjitha te perkthyer dhe te noterizuar sipas ligjit).

Theksojme se, ne kete rast KVO-ja, nqs do te kishte paqartesi per autorizimet, duhet te shfrytezonte te drejten dhe detyrimin qe i jep ligji, buke kerkuar sqarime ose nga neve si OE ofertues, ose nga autorizuesi yne TOOLS MARKET (kontaktet e te cilit jane tek autorizimi perkates), gje te cilen KVO ja nuk e ka bere, poor eshte nxituar ne skualifikimin tone, pa marre ne konsiderate autorizimin perkates nga distributori TOOLS MARKET !!!

Sa me siper pretendimi i pare i KVO-se, bie.

1-Persa i perket arsyes se dyte te skualifikimit, (2- OE Bajro Bros shpk, nuk ploteson piken 4 Kapaciteti Teknik 1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose/dhe skeda teknike të mallrave objekt prokurimi, të cilat kërkohen në tabelën e mësipërme, të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST?????.., pasi lidhur me katalogun e paraqitur nga ana e OE, JANE KONSTATUAR

MOSPERPTHJE TE DUKSHME Tduke analizuar zerat e katalogut nga ana e OE Bajro Bros, ne permbushje te kriterit, KVO nga analizimi I dokumentacionit te ngarkuar ne SPE , konstaton se zerat e katalogut te paraqitur nga ana e OE, jane konstatuar mosperputhje te dukshme ndermjet ST teknike te kerkuara dhe produkteve te paraqitura per zerat. GJENERATOR ELEKTRIK 7 KW ñ SERIA GV dhe MOTO GJENERATOR MONOFAZE 3.3 KVA. Nga kerkimi ne web per GJENERATOR

ELEKTRIK 7 KW ñ SERIA GV dhe MOTO GJENERATOR MONOFAZE 3.3 KVA, del me logon

LYNX dhe ne asnje nga dokumentacionet e autorizimeve per distributor apo prodhues, nuk behet lidhja ndermjet tyre dhe markes LYNX. Keto mosperputhje tregojne qarte qe katalogu i paraqitur nuk perfaqeson dokumentacionin te sakte dhe te verifikueshem te nje prodhuesi apo distributor te autorizuar nga prodhuesi, pas nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga distributoret TOOLS MARKET dhe MUCA, verehet se produktet e paraqitura nga OE Bajro Bros ne katalogun e tij, kane mosperputhje me ST dhe fotot ilustruese, dhe per disa zera, nuk ekzistojne fare ne faqet e web perkates te dy distributoreve),

theksojme se:

KVO-ja perkatese, ose nuk e ka pare fare katalogun e paraqitur nga ana jone ose nuk e ka krahasuar ate me ST te DT, por eshte nxituar duke deklaruar apriori se katalogu nuk perputhet me ST te DT, poor pa dhene asnje detaj konkret se cili nga artikuj ne kataog nuk perputhet me ST, si dhe dhe cilat ST nuk perputhen me DT !!!

Sqarojme se, ne permbushje te pikes 4 te kapacitetit Teknik te kerkesave per kualifikim te DT: ipiken 4. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve ose/dhe skeda teknike te mallrave objekt prokurimi, te cilat kerkohen ne tabelen e mesipërme, te perkthyer ne gjuhen shqipe, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen ne menyre qe te krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST?????., ”,

Neve kemi paraqitur katalogun perkates per te gjithë artikujt e kerkuar, dmth për zërat 1.2.3.5.10.11.12, dokumentin me emertimin - 12-KATALOG (ekstrakt) VP v2, ne te cilin jane te pasqyruara teresisht pa asnje mangesi, pike per pike, te gjitha ST te DT, per te 7 artikujt e kerkuar, perfshire edhe dy artikujt e pretenduar nga KVO-ja - GJENERATOR ELEKTRIK 7 KW ñ SERIA GV dhe MOTO GJENERATOR MONOFAZE 3.3 KVA. Nga kerkimi ne web per GJENERATOR ELEKTRIK 7 KW ñ SERIA GV dhe MOTO GJENERATOR MONOFAZE 3.3 KVA, (shih

katalogun bashkelidhur dhe krahasoje me ST te DT). I kujtojme KVO -se,se:

si per te shtate artikujt e tjere, edhe per keto dy artikuj, tek ST te DT, nuk eshte kerkuar nje marke e caktuar (kjo sipas ligjit), por jane dhene ST te tyre, artikuj te cilet mund ti prodhojne shume prodhues te ndryshem dhe jo vetem LYNX, apo prodhues qe mendon KVO-ja.

gjithashtu i kujtojmë KVO-se se, ne asnjë vend të DT nuk është kërkuar që produktet e ofruara në katalog, duhet të jenë patjetër të pasqyruara në web -in e distributorit !!, pasi çdo prodhues apo distributor apo shites, e ka në tagrin e vet se çfarë deshiron të publikojë në web in e tij. Gjithashtu, i kujtojmë KVO-se, se ne asnjë vend të DT, nuk është kërkuar që katalogu duhet të jetë me logon e prodhuesit apo të distributorit. Kështu që katalogu jone është paraqitur nën logon tone.

Autorizuesi jone TOOLS MARKET, na ka ofruar ofertën për artikujt perkates, se bashku me fotot dhe ST perkatese, artikujt të cilët, neve i kemi pasqyruar në katalogun tone, dorezuar në SPE. Sipas ligjit, vlerësimi i ofertave duhet të bëhet VETEM dhe vetëm, duke krahasuar dokumentat e paraqitura nga OE në SPE, me me kërkesat e DT.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. PËR PASOJË, OPERATORËT EKONOMIKË PJESEMARRËS NË NJË PROCEDURË PROKURIMI DUHET TË PLOTËSOJNË KËRKESAT E VENDOSURA NË DOKUMENTET E TENDERIT, E RRJEDHIMISHT, VLERËSIMI E KUALIFIKIMI I TYRE DUHET TË BËHET NË PËRPUTHJE VETËM ME KËTO KËRKESA.

Edhe në këtë rast, nëq KVO-ja, do të kishte paqartësi për katalogun, përpara se të bënte vlerësimin e ofertës, duhet të shfrytëzonte të drejtën dhe detyrimin që i jep ligji, buke kërkuar sqarime ose nga neve si OE ofertues, ose nga autorizuesi ynë distributori TOOLS MARKET (kontaktet e të cilëve janë tek autorizimi perkates), gjë të cilën KVO ja nuk e ka bërë, por është nxituar në skualifikimin tone, duke pretenduar dëkë të pavërtetë se që katalogu nuk përputhet me ST të DT.

Sa me sipër, edhe pretendimi i dytë i KVO-se, bie.

Si rrjedhim, me faktet dhe argumenta të paraqitura nga ana jone, bëjnë poshtë pretendimet e KVO-se, mbi arsyet e refuzimit të ofertës tone.

B - Në lidhje me kërkesën tone për mbetjen e skualifikuar të ofertës së OE - ERVIN LUZI, kërkojmë nga KSHA, ja,

Lenien të skualifikuar të ofertës së OE - ERVIN LUZI, me arsyet e gjetura nga ana e KVO-se.

PERFUNDIMISHT, KËRKOJME

A- SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TE KVO-SE, mbi skualifikimin e ofertes se shoqerise BAJRO BROS, ne kete procedure prokurimi, duke e kualifikuar ate.

B- Mbetjen e skualifikuar te ofertes se OE - ERVIN LUZI ”

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1365/1 prot., datë 04.05.2026, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1365 prot, datë 04.05.2026.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 932/17 prot., datë 12.05.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1365/2 prot., datë 12.05.2026, të ardhur nëpërmjet sistemit elektronik është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi i KSHA –së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues,

I njëjti vendim është përcjellë nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.933/19 prot., datë 12.05.2026 protokolluar me tonën me shkresën nr. 1365/3 prot., datë 14.05.2026.

Referuar vendimkt të KSHA-së konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të saj.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga AK me argumentimin se: ““• *Operatori Ekonomik “Bajro Bros” sh.p.k nuk ploteson piken 2 Kapaciteti teknik: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe*

Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST.....Pasi KVO konstaton nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të kompanisë përkatëse rezulton se “Sarac Teknik Hirdavat” dhe analizimi i dokumentacionit ngarkuar ne SPE për autorizimin e paraqitur, nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, por një distributor i disa markave. Në këto kushte, autorizimi i paraqitur nga ana juaj, i lëshuar nga një subjekt që nuk ka statusin e prodhuesit, nuk përmbush kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe konsiderohet i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë me prodhuesin apo përfaqësimin e autorizuar prej tij.

• Operatori Ekonomik “Bajro Bros” sh.p.k nuk ploteson piken 4 Kapaciteti teknik.: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose/dhe skeda teknike të mallrave objekt prokurimi, të cilat kërkohen në tabelën e mësipërme, të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST.pasi lidhur me katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” në përmbushje të kriterit KVO nga analizimi i dokumentacionit ngarkuar ne SPE ,konstaton se zërat e katalogut të paraqitur nga ana e OE, janë konstatuar mospërputhje të dukshme ndërmjet specifikimeve teknike të kërkuara dhe produkteve të paraqitura për zërat GJENERATOR ELEKTRIK 7 kW – SERIA GV dhe MOTORGJENERATOR MONOFAZË 3.3 kVA. Nga kerkimi ne web per GJENERATOR ELEKTRIK 7 kW dhe MOTORGJENERATOR MONOFAZË 3.3 kVA del me logon e LYNX dhe ne asnje nga dokumentacionet e autorizimeve per distributor apo prodhues nuk behet lidhja ndermjet tyre dhe markes LYNX. Këto mospërputhje tregojnë qartë se katalogu i paraqitur nuk përfaqëson dokumentacionin teknik të saktë dhe të verifikueshëm të një prodhuesi apo distributori të autorizuar nga prodhuesi pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga distributoret TOOLS MARKET dhe MUCA shpik verëhet se produktet e paraqitura nga OE Bajro Bros ne katalogun e tij kane mosperputhje me specifikimet teknike dhe fotot ilustruese dhe per disa zera nuk rezultojne fare ne faqet e web perkates te dy distributoreve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr. 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2 të dokumenteve të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar shprehimisht:

“2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 te DST.”

III.1.2. Në shtojcën nr. 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4 të dokumenteve të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar shprehimisht:

“4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose/dhe skeda teknike të mallrave objekt prokurimi, të cilat kërkohen në tabelën e mësipërme, të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. Për zërat 1.2.3.5.10.11.12 Referohu në shtojcën 7 të DST.”

III.1.3. Në shtojcën 7 “Formulari i Specifikimeve teknike” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emri	Njesia	Sasia
1	Gjenerator 7 KW	Cope	3
2	Motorgjenerator Monofazë 3.3KVA	Cope	1
3	Matrapik dore profesional SDS	Cope	5
4	Matrapik thyes me benzin	Cope	1
5	Matrapik SDS + me dy bateri 42W (5AH) 4.5JV(28mm ingo)	Cope	10
6	Shkalle dyshe	Cope	6
7	Guri fresibel I vogel	Cope	7
8	Gur fresibel I madh	Cope	4
9	Gur fresibel+vidator+trapan me goditje me bateri set	Cope	6
10	Vidator me bateri + karikus	Cope	8
11	Fryrese Ajri per pastrim gjethesh me bateri	Cope	3

12	Trapan dore profesional	Cope	8
13	Motosharr betoni dore	Cope	3
14	Motosharr betoni	Cope	3
15	Batitor me depozite uje 40-50 kg	Cope	3
16	Aparat saldimi inverter Mig 160 S,230 50/60HZ rryma ne dalje -30-160A trashesia e pllakave te saldimit 0.1-200mm	Cope	3
17	Perzire kolli me bateri	Cope	2
18	Preres bari	Cope	9
19	Paranko 2 ton	Cope	2
20	Pistolet per lyerjen me depozite 100 cc Dia 0.8-1.3 mm	Cope	1
21	Traspalete	Cope	1
22	Frezë per hapje gropash 50mm 65mm, 80 mm	Cope	1
23	Adaptor per matrapik	Cope	5
24	Motor pomp set	Cope	1
25	Pistolet dadi cekesh	Cope	2
26	Saldatrice profesionale	Cope	1
27	Kompresor 16 kg me korent	Cope	1
28	Krik mekanik I fuqishem per heqje gomash	Cope	1
29	Krik- vinc per heqjen e motorreve	Cope	1
30	Pistolet e fuqishme me bateri per gomat dhe pjeset mekanike	Cope	1
31	Pistolet ajri 3/4	Cope	1
32	Pajisje (pompe) per furnizim diferencial -kambio me vaj	Cope	1
33	Ure ngritese per furgona e vetura 6 ton	Cope	1
34	Starter per karikim baterie e ndezje mjetesh	Cope	1
35	Kompresor ajri	Cope	1

36	Karroce me vegla	Cope	1
----	------------------	------	---

Afatet e lëvrimit: Nga lidhja e marrëveshjes kuadër deri në plotësim të nevojave të Autoritetit

II.1.5 Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon::

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1-Gjenerator 7 KW

Fuqia nominale: 5.5 kVA

Rryma nominale: 23.9 A

Tensioni nominal: 230 V

Pesha: 72 kg

Lloji i ftohjes: me ajër

Gjatësia për transport: 0.735 m

Gjerësia për transport: 0.51 m

Lartësia për transport: 0.52 m

Seria e modelit: GV

Lloji i motorit: GX390

Fuqia e motorit: 8.2 kW

Cilindrata: 0.389 l

Rrotullimet në momentin maksimal: 3000 rpm

2-Motorgjenerator Monofazë 3.3KVA

Fuqia maksimale: 3 100 W

Fuqia e qëndrueshme: 2 800 W

Tensioni dalës: 230 V (njëfazor)

Rryma dalëse: 12.2 A

Frekuenca: 50 Hz

Motor: Loncin me fillim manual

Rregullimi automatik i tensionit (AVR): Po

Kapaciteti i rezervuarit të karburantit: 9 L

Përdorimi: Deri 8 orë punë me 50 % ngarkesë

Niveli i zërit: rreth 96 dB(A)

Pesha neto: rreth 44 kg

Mbrojtje: IP23

3-Matrapik dore profesional SDS

SPECIFIKIMET

- Tensioni: 220–240 V ~ 50/60 Hz
- Fuqia hyrëse: 1200 W
- Shpejtësia pa ngarkesë: 235–514 rpm
- Shkalla e ndikimit: 1350–2950 goditje/min
- Energjia e ndikimit: 2–10 J
- Kapaciteti maksimal i shpuarjes:
 - Betoni: 42 mm
 - Bimetali (core bit): 90 mm
- Sistem kapëse: SDS MAX
- Elektronikë për fuqi konstante
- Kontroll i shpejtësisë së ndryshueshme
- Sistem kyçjeje për dliërë (Chisel-locking system)
- Sistem dyfishe anti-vibracioni
- Indikator i furnizimit me energji

4-Matrapik thyes me benzin

-Ndikim i lartë i energjisë së pistonit dhe në peshe të ulët

-Sistem godites i fuqishëm dhe i qëndrueshëm

-Doreze e qëndrueshme dhe e balancuar mirë

-Me manual përdoruesi

Specifikime teknike:

Intervali lubrifikimit: 18-22 ore

Motorri metrik

Menaxhimi i lëndës djegëse: Karburator

Menyra e funksionimit të motorrit: 2 cilindër

Fohja: me ajër

Konsumimi i lëndës djegëse: 1-2 L/std

Lloji i lëshimit: me terheqje

Lloji i motorrit: me benzine

Cilindër: 1

Kapaciteti cilindrik: 75-85 cm³

Kapaciteti rezervuarit: 1,50-2 L

Shpejtësia nominale e motorrit: 4000-4500 1/min

5-Matrapik SDS + me dy bateri

- Motor: Pa furçë (Brushless)

- Tensioni: 20 V
- Shpejtësia pa ngarkesë: 0–930 rpm
- Shkalla e ndikimit: 0–4400 goditje/min
- Forca e një goditjeje: 4.5 J
- Kapaciteti maksimal i shpuarjes:
 - Betoni: 28 mm
 - Çeliku: 13 mm
 - Druri: 40 mm
- Sistem kapëse: SDS Plus
- Paketë përfshin: 3 thika shpuese (8 mm, 10 mm, 12 mm)

6-Shkalle dyshe

Shkalle multifunkionale alumini

Te jene te pershtatshme per te punuar ne te dy krahjet

Gjatesi 500-1000 cm

Materiali Alumin

7-Guri fresibel I vogel

Tensioni: 220-240 V,50/60 Hz

Fuqia ne hyrje: 700-800 W

Shpejtesia pa ngarkese: 11000 rpm

Diametri diskut: 115 mm

Fileto e bushtit rrotullues: M14

Me 1cope doreze shtese

8-Gur fresibel I madh

Tensioni: 230 V,50 Hz

Fuqia ne hyrje: 2300-2500 W

Shpejtesia pa ngarkese: 6000-6400 rpm/min

Diametri diskut: 230 mm

Pesha: 6-7 kg

9-Gur fresibel+vidator+trapan me goditje me bateri set

Energjia e goditjeve: 2.5 J

Kapaciteti maksimal I shpimit: diametric 26 mm ne beton

Me ndricim te integruar per vendin e punes

Me system te madrinos SDS plus

Gërryese këndore me bateri

Motor pa furca

Shpejtesia pa ngarkese: 3000/6000/9000 rpm

Diametri diskut: 115 m

Filetimi bushtit: M14

Llampa e punes

Fuqia e nxehtesise Led: 5 W

Lumen: 270±10%

Perfshire:

3 cope priza

3 cope punto shpimi

1 cope dalte

1 set 115 mm metal abraziv per prerje disku

47 cope aksesor

1 cope karikues

Tensioni I karikimit: 220-240 V,50/60 Hz

Tensioni: 20 V

Me 1 cope shpues elektrik portativ

Me 1 cope vidator

Me 1 cope cekic rrotullues pa kabell

Me 1 cope llampe pune

Vidator

Motor pa furce

Fundi I celesit godites: ½"

Shpejtesia pa ngarkese: 0-1600/0-1900/0-2300 rpm

Shkalla e goditjeve : 0-2100/0-2500/0-2900 bpm

Cifti rrotullues: 400 nm

Vidator shpues me motor pa furca

Motorr pa furca

Shpejtesia pa ngarkese: 0-550/0-2000 rpm

Forca rrotulluese maksimale: 52 Nm

Mandrino plastic

Rregullimet e ciftit : 22+1

Dy marsha shpejtesia mekanik

Cekic elektrik rrotullues me bateri

Motorr pa furca

Shpejtesia pa ngarkese: 0-1100 rpm

Shkalla e goditjeve: 0-5000 bpm

10-Vidator me bateri + karikus

- *Motor: Pa furça (Brushless)*
- *Tensioni: 16 V*
- *Shpejtësia pa ngarkesë: 0–550 / 0–2000 rpm*
- *Tensioni maksimal (Torque): 60 Nm*
- *Kapëse: Metalike*
- *Kapaciteti i kapëses: 13 mm*
- *Përcaktimet e tensionit (Torque settings): 22+1*
- *Kapëse pa çelës me bllokim automatik*
- *Kutia mekanike me 2 shpejtësi*
- *Funksioni i bllokimit të boshtit (Spindle lock)*
- *Dritë LED e integruar për punë*

Përfshin paketën:

- 1 thikë Cr-V 65 mm
- 2 bateri M16 2.0Ah 16V (TFBLI1620)
- 1 karikues M16 (TFCLI1613)
- Tensioni i karikimit: 220–240 V ~ 50/60 Hz

11-Fryrese Ajri per pastrim gjethesh me baterim

Motor pa furca

Tensioni: 20 V

Shpejtesia pa ngarkese: 15000 rpm

Vellimi mesatar I ajrit: 8.5m³/min

Shpejtesia maksimale e ajrit: 42 m/s

12-Trapan dore profesional

Tensioni: 230V-50Hz

Fuqia: 1010 W

Shpejtesia pa ngarkese: 0-2800 rpm/min

Shkalla e goditjeve: 0-44800 bpm/min

Kapaciteti shpimit: 13 mm

13-Motosharr betoni dore

Specifikime teknike:

- Fuqi e lartë 4 kW për prerje të forta
- Thellësi prerjeje deri në 145 mm
- Disk 400 mm me vrimë montimi 25.4 mm
- Sistem furnizimi me ujë (0.1–0.5 MPa) për reduktim pluhuri
- Dridhje të reduktuara për rehati më të madhe gjatë punës
- Peshë 12 kg – balancë e mirë mes fuqisë dhe manovrimit
- Rrotullime: 4700 rpm
- Kapacitet motori: 93.6 cm³
- Raporti vaj/karburant: 40:1
- Kapacitet rezervuari: 1 litër
- Konsum maksimal: 2105 g/h
- Numri i cilindrave: 1
- Motor 2-taktësh
- Momenti i shtrëngimit të diskut: 15–25 Nm

14-Motosharre betoni

Tipi i pajisjes	Makine prerëse për asfalt dhe beton (Floor Saw)
Modeli	BFS1345
Motor / Prodhuesi	Honda GX390
Cilindrat e motorit	389 cm ³
Fuqia e motorit	8.7 kW (rreth ~11.7 HP)
Lloji i karburantit	Benzinë
Kapaciteti rezervuarit të karburantit	6.1 l

<i>Tipi i pajisjes</i>	<i>Makine prerëse për asfalt dhe beton (Floor Saw)</i>
<i>Konsumi i karburantit</i>	<i>~4.3 l/h</i>
<i>Diametri maksimal i diskut</i>	<i>450 mm</i>
<i>Diametri i brendshëm i diskut</i>	<i>25.4 mm</i>
<i>Thellësia maksimale e prerjes</i>	<i>170 mm</i>
<i>Shpejtësia nominale e diskut</i>	<i>2200 rpm</i>
<i>Kapaciteti i rezervuarit të ujit</i>	<i>32 l</i>
<i>Dimensionet (L×GJ×H)</i>	<i>860 × 575 × 1010 mm</i>
<i>Pesha netto</i>	<i>93 kg</i>

15-Batitor me depozite uje

<i>Tipi i pajisjes</i>	<i>Pllakë vibratore njëdrejtimëshe</i>
<i>Motor</i>	<i>Benzinë, 4-takt</i>
<i>Prodhuesi i motorit</i>	<i>Briggs & Stratton XR550 ose Honda GX120 (variante)</i>
<i>Cilindrata e motorit</i>	<i>Rreth 118–127 cm³</i>
<i>Fuqia e motorit</i>	<i>~2.6 kW (3.5 PS)</i>
<i>Shpejtësia e punës</i>	<i>3600 rpm</i>
<i>Fuqia centrifugale</i>	<i>~11 kN</i>
<i>Shpejtësia e lëvizjes para</i>	<i>~26 m/min</i>
<i>Kapaciteti i sipërfaqes së përpunuar</i>	<i>~546 m²/h</i>
<i>Gjerësia e pllakës së punës</i>	<i>~350 mm</i>
<i>Trashësia e pllakës</i>	<i>~5 mm</i>
<i>Dimensioni i pllakës (G × L)</i>	<i>~350 mm × 599 mm</i>
<i>Pesha operative</i>	<i>Rreth 58–63 kg</i>
<i>Niveli i vibrimit (ah)</i>	<i>~4.5 m/s²</i>

16- Aparat saldimi inverter Mig 160 S,230 50/60HZ

Specifikime Teknike

Tensioni hyrës: 110–120V / 220–240V

Frekuenca: 50/60 Hz

Tension pa ngarkesë: 84V

Cikli i punës: 30% @ 40°C

Në 220V:

- *MAG/MIG: 30–160A*
- *MMA: 15–160A*
- *TIG Lift: 15–160A*

Në 110V:

- *MAG/MIG: 30–130A*

- MMA: 15–130A
- TIG Lift: 15–130A

-
- Ekran LED për rregullim të saktë
 - Furnizues teli i integruar
 - Për bobinë teli deri në 5 kg
 - Diametri i telit: 0.6 / 0.8 / 1.0 mm
 - Shpejtësia e telit: 2–11 m/min
 - Diametri i elektrodës MMA: 1.6–4.0 mm
 - Spinë UL

17- Perzire kolli me bateri

Specifikime Teknike

- Tensioni: 20V
- Shpejtësia pa ngarkesë: 0–650 rpm
- Fije e boshtit të përzierjes: M14
- Kuti ingranazhesh: Alumini
- Kontroll shpejtësie: Po

18-Preres bari

Specifikime Teknike

- Kapaciteti i motorit: 42.7 cc
- Fuqia nominale: 1.25 kW
- Shpejtësia maksimale: 8000 rpm
- Gjerësia maksimale e prerjes: 420 mm
- Motori: 2-taktësh, një cilindër
- Ftohja: Me ajër
- Kapaciteti i rezervuarit të karburantit: 1200 ml
- Tub furnizimi me karburant: Tub PUR me dy shtresa

19- paranko 2 ton

Kapaciteti ngritës: 2 Ton

Lartësia e ngritjes: 3 m

Numri i zinxhirëve të ngarkesës: 1

Distanca grep-më-grep: 485 mm

Forca e tërheqjes për ngarkesë maksimale: 343 N

Pesha neto: 19.5 kg

20- Pistoletë për lyerjen me depozite

Gjerësia e modelit të spërkatjes: 140–180 mm

Kapaciteti i depozitës së bojës: 1000 cc

Presioni i punës: 3–4 bar

Konsumi i ajrit: 4.2–7.1 CFM (119–201 l/min)

Gryka opsionale (nozzle): 1.2 – 1.8 mm

21-Transpalette

Kapaciteti ngritës: 2.500 kg

Lartësia e forkës: 8.5 – 20 cm

Madhësia e forkës: 55 × 115 cm

Rrota drejtuese: 200 mm

Rula ngarkese (tandem): 80 mm

Pesha: 65 kg

22- Frezë per hapje gropash

- Kapacitet motorri: 52 cc
- Fuqia motorri: 1.49 kW
- Lloji i karburantit: Benzinë
- Përdorimi: Kopsht, parcelë, fermë e vogël

23- Adaptor per matrapik

Lejon përdorimin e aksessoreve SDS-Plus në çekiç me çak SDS-Max

I bërë nga çelik rezistent ndaj nxehtësisë për jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri

Zëvendësim i lehtë i aksesorëve, pa mjete shtesë

Nuk kërkon kyçje të veçantë në çakun e çekiçit

Heqje e thjeshtë e stërvitjes ose aksesorit

24- Motor pomp set

- Lartësia maksimale e shpërndarjes: 88 ft
- Kapaciteti i shpërndarjes: 290 US gpm
- Lartësia e thithjes: 25 ft
- Diametri maksimal i grimcave: 0.25 in

Motorri:

- Lloji: Motor benzine, ajrosje me një cilindër
- Prodhues: Honda
- Kapaciteti i motorit: 9.9 in³
- RPM operativ: 3,600 rpm
- Fuqia maksimale: 4.8 hp (SAE J1349)

Karburanti dhe konsumi:

- Kapaciteti i vajit: 0.63 US qt
- Lloji i karburantit: Benzinë
- Konsumi: 0.47 US gal/h
- Kapaciteti i rezervuarit të karburantit: 3.8 US qt
- Koha maksimale e punës (runtime): 2.1 h

25- Pistolete dadi cekesh

- Motor: Brushless (pa furça)
- Tensioni: 20V
- Furca katrore: 3/4"
- Shpejtësia pa ngarkesë: 0–900 / 0–1200 / 0–1800 rpm
- Shkalla e goditjes: 0–1800 / 0–2000 / 0–2200 bpm
- Moment shtrëngimi: 1350 Nm

- Moment çmontimi (Nut-Busting): 1900 Nm
- Drita pune e integruar: Po

26-Saldatrice profesionale

Teknologjia: IGBT Inverter

Tensioni hyrës: 380–400V, trefazor

Frekuenca: 50/60 Hz

Rryma dalje: 20–400A

Rryma maksimale: 400A

Cikli i punës: 400A @ 60%

Tension pa ngarkesë: 68V

Diametri i elektrodës: 2.5–5.0 mm

27- Kompresor 15 kg me korent

Tensioni: 220–240V~50Hz

Fuqia e hyrjes: 1100 W (1.5 HP)

Kapaciteti i rezervuarit: 15 L (4 Gal)

Motor: Tel alumini, pa vaj

Shpejtësia pa ngarkesë: 2850 rpm

Presioni maksimal i punës: 8 bar

Niveli i zërit: 67 dB

28- Krik mekanik I fuqishem per heqje gomash

- Kapaciteti ngritës: 50 Ton

- Lartësia minimale: 30 cm

- Lartësia maksimale: 48 cm

- Pesha neto: 32.2 kg

•

29- Krik- vinc per heqjen e motorreve

kapacitet maksimal ngritës: 1 ton (454 kg)

Madhësia e objekteve për terheqje: 25–2 040 mm (80 in)

Dimensionet: 1510 × 1015 × 1 545 mm (L × W × H)

Pesha: 69–75 kg

Krah i rregullueshëm: 4 pozicione për mbajtje optimale të peshës

30- Pistoletë e fuqishme me bateri per gomat dhe pjeset mekanike

- Motor: Brushless (pa furça)

- Tensioni: 20V

- Furça katrore: 1/2"

- Shpejtësia pa ngarkesë: 0–1600 / 0–2100 / 0–2400 rpm

- Shkalla e goditjes: 0–1500 / 0–1800 / 0–2200 bpm

- Moment shtrëngimi: 850 Nm

- Moment çmontimi (Nut-Busting): 1000 Nm

- *Drita pune LED e integruar: Po*

31-Pistolet ajri ¾

- *Moment maksimal: 1.600 Nm*
- *Konsumi i ajrit: 256 l/min*
- *Presioni i punës: 6.2 bar*
- *Shpejtësia pa ngarkesë: 4.000 rpm*
- *Gjatësia e çelësit: 234 mm*
- *Hosa ajri: 1/2"*
- *Pesha: 5.9 kg*

32-Pajisje (pompe) per furnizim diferencial -kambio me vaj

Një makinë thithëse e krijuar për mbushjen ose thithjen nga rezervuarët e makinerive të lëngjeve funksionuese, të tilla si vaji i motorit dhe i transmisionit, ftohësi dhe lëngu i frenave. Kapaciteti: 500 ml Kapaciteti: 500 ml

33- Ure ngritese per furgona e vetura 6 ton

Kapacitet ngritës: 6.0 ton

Krahë teleskopikë: 3-segmentësh për fleksibilitet maksimal

Përdorim: Veturat e pasagjerëve, furgonë të lehtë, autokamperë

Siguri e lartë operimi

Mbajtëse praktike për adapterë zgjatues në secilën shtyllë

34- Starter per karikim baterie e ndezje mjetesh

- *Tensioni hyrës: 220–240 V, 50/60 Hz*
- *Tensioni i karikimit: 12/24 V*
- *Rryma nominale: 16/18 A*
- *Rryma boost: 20 A*
- *Kapaciteti i referencës së baterisë: 70–300 Ah*
- *Klasa e izolimit: H*
- *Pesha: 15 kg*

35- kompresor ajri 500liter

- *Tensioni hyrës: 380V ~ 50Hz, trefazor*
- *Fuqia e hyrjes: 5.5 kW (7.5 HP)*
- *Kapaciteti i rezervuarit: 500 L*
- *Niveli i zërit: 83 dB*
- *Motor: Induksion me tela bakri*
- *Sistem ngasjeje: Belt drive (me rrip)*
- *Lubrifikimi i pompës: Me vaj*
- *Presioni maksimal operativ: 8 bar*
- *Garanci jetëgjatësie: 3000 orë*

36- Karroce me vegla

- Sirtarë: 7 pjesë (5 të hollë + 2 të thella)
- Madhësia totale: 765 × 465 × 812 mm
- Madhësia me rrota: 765 × 465 × 976 mm
- Rrotat: 5 × 2 inç
- Trashësia e kabinetit: 0.8 – 1.0 mm
- Trashësia e sirtarit: 0.7 mm
- Sirtarë të hollë: 536 × 410 × 74.5 mm
- Sirtarë të thellë: 536 × 410 × 153.5 mm
- Krochet hekuri për vegla: 5 copë

Shënim: Për çdo çetifikatë, standart markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipër marrës të përmëndur më lart, panohet edhe ekuivalenti i tyre

III.1.6 Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.4 dhe 2.3.2 të shtojcës nr. 8, të dokumentave të tenderit operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK ka dorëzuar në SPE:

- Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” ku operatori ekonomik ka plotësuar Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” A: Deklaratë “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”.
- Dokumentin pdf të emërtuar Katalog_(ekstrakt)_VA.
- 10-Autorizime nga distributores të cilat përmban :
 - Autorizim i datës 07.04.2026 për shoqërinë “Bajro Bros” shpk nga shoqëria distributore “Tools Market” Shpk
 - Autorizim prodhuesi i kompanisë SOLA-Messwerkzeuge për shoqërinë “Tools Market” Shpk
 - Autorizim prodhuesi i kompanisë Husqvarna Construction për shoqërinë “Tools Market” Shpk
 - Autorizim prodhuesi i kompanisë HogertTechnik GmbH për shoqërinë “Tools Market” Shpk
 - Autorizim prodhuesi i kompanisë Emerson Comercial & Residential Solution për shoqërinë “Tools Market” Shpk
 - Autorizim prodhuesi i kompanisë Makita për shoqërinë “Tools Market” Shpk
- Autorizim nga distributori 2 e cila përmban :
 - Autorizim i datës 04.06.2025 për shoqërinë “Bajro Bros” shpk nga shoqëria distributore “MUCA” Shpk
 - Autorizim si i kompanisë Sarac Teknik Hirdavat për shoqërinë “MUCA” Shpk

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.7. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.8. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.9. Në nenin 40 pika 3 dhe 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.....

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

III.1.10. Në nenin 36 , të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi 8 ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor"

III.1.11. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u

përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave/shërbimeve të ofertuara prej tyre me ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues të cilët me dokumentacionin e dorëzuar garantojnë përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.4, kapaciteti teknik, dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.4, kapaciteti teknik, KPP konstaton, se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e pikës 2.3.4 të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit për produktet që ka ofruar dhe që janë kërkuar të prokurohen nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 2.3.4 kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit është në përputhje me produktet e kërkuara në procedurën e prokurimit objekt prokurimi, si dhe është një kërkesë e ligjshme e në përputhje me gërmën “b”, të pikës 6 të nenit 40 të VKM 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë.* Nga interpretimi telologjik (qëllimi i normës juridike) Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit të parashikuar në pikën 2.3.4, kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit është një kërkesë e argumentuar nga ana ligjore dhe që i shërben autoritetit kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të produktit/eve të ofruara nga operatori ekonomik pjesëmarrës me specifikimet teknike të produktit/produktet të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër, nga interpretimi në tërësi, duke iu referuar interpretimit gjuhësor dhe atij telologjik të dispozitës së mësipërme,

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se edhe pse se nga ana e KVO nuk janë dhënë shpjegime në mënyrë shteruese, lidhur me mospërbushjen e elementëve të specifikimeve teknike të sipërpërmendura në shtojcën 6 të dokumentave të tenderit nga operatori ekonomik ankimes. dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik për përmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.4, kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit, përmban të dhëna të qarta, si përshkrimin, karakteristikat, foto të tyre, emërtimin dhe specifikimet teknike të artikullit që ofertohej në gjuhën shqipe, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në lidhje me arsyen e skualifikimit se: *“...konstaton se zerrat e katalogut të paraqitur nga ana e OE, janë konstatuar mospërputhje të dukshme ndërmjet specifikimeve teknike të kërkuara dhe produkteve të paraqitura për zerrat GJENERATOR ELEKTRIK 7 kW – SERIA GV dhe MOTORGJENERATOR MONOFAZË 3.3 kVA. Nga kerkimi ne web per GJENERATOR ELEKTRIK 7 kW dhe MOTORGJENERATOR MONOFAZË 3.3 kVA del me logon e LYNX dhe ne asnje nga dokumentacionet e autorizimeve per distributor apo prodhues nuk behet lidhja ndermjet tyre dhe markes LYNX. Këto mospërputhje tregojnë qartë se katalogu i paraqitur nuk përfaqëson dokumentacionin teknik të saktë dhe të verifikueshëm të një prodhuesi apo distributori të autorizuar nga prodhuesi pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga distributoret TOOLS MARKET dhe MUCA shpk verehet se produktet e paraqitura nga OE Bajro Bros ne katalogun e tij kane mosperputhje me specifikimet teknike dhe fotot ilustruese dhe per disa zera nuk rezultojne fare ne faqet e web perkates te dy distributoreve.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi në rastin konkret, dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK, për përmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.4, kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit përmban në brendinë e tij të gjithë informacionin dhe elementet e kërkuara në kriterin e veçantë të kualifikimit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Argumentimi se specifikimet teknike për artikuj e sipërcituar janë të njëjta me ato të markës LYNX nuk qëndron për faktin se specifikimet për artikujt e kërkuar nga autoriteti kontraktor mund të përmbushen nga shumë marka prodhuesish. Fakti që një artikull me specifikimet e kërkuara del me logo të një marke sdo të thotë që marka të tjera nuk i kanë këto lloj specifikimesh e për më tepër jo detyrimisht duhet të jenë në faqet eeb.

Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenin 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe nenit 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenit 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik,

është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar. Operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK, me dokumentacionin e paraqitur, plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.4, kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Lidhur me arsyen tjetër të skualifikimit të operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK se ..” nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të kompanisë përkatëse rezulton se “Sarac Teknik Hirdavat” dhe analizimi i dokumentacionit ngarkuar në SPE për autorizimin e paraqitur, nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, por një distributor i disa markave. Në këto kushte, autorizimi i paraqitur nga ana juaj, i lëshuar nga një subjekt që nuk ka statusin e prodhuesit, nuk përmbush kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe konsiderohet i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë me prodhuesin apo përfaqësimin e autorizuar prej tij...” Komisioni nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, ku të vërtetohet se është i autorizuar të tregëtojë produktete që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektit të prokurimit..Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.5. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni konstaton se autorizimi i paraqitur nga ky operator ekonomik është lëshuar nga kompania “Tools Market” SHPK e cila rezulton të jetë distributor prodhues i artikujve objekt prokurimi i kompanive prodhuese SOLA-Messëerkzeuge, Husqvarna Construction, Hogert Technik GmbH dhe Emerson Commercial & Residential Solution. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Referuar autorizimeve të prodhuesve të dorëzuar në SPE dhe autorizimit të distributorit nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ka dorëzuar autorizim nga prodhuesit dhe distributorit, ku pasqyrohen kompania

prodhuese apo distributore dhe të dhënat e identifikimit të tyre, duke dhënë një indicie që e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit. Duke marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, konstaton se arsyeja e skualifikimit se ...”*lidhur me autorizimin e paraqitur, nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të kompanisë përkatëse rezulton se “Sarac Teknik Hirdavat” nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, por një distributor i disa markave..*”, Komisioni gjykon se kriteri quhet i përmbushur me dorëzimin e autorizimit të lëshuar nga kompania “Tools Market” SHPK. Pra, operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me dokumentacion e paraqitur përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.2 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK përsa i perket Operatorit ekonomik Ervin Luzi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 23.04.2026, ku ky operator ekonomik rezulton i skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që ky operator ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për operatorin ekonomik Ervin Luzi nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, në procedurën e prokurimit “E Hapur, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24(njëzet e katër) muor”, me REF-78968-03-11-2026, me objekt: “Blerje vegla pune”, me fond limit 11,288,300 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën

15.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

